**VENDIM**
**Nr. 67, datë 14.2.2024**

# PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 2444, BASHKIA LIBOHOVË, QARKU GJIROKASTËR, NGA SHOQËRIA "*FAETHON*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër, nga shoqëria "*FAETHON"* sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: shoqëria "*FAETHON*" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal NIPT/NUIS: M21928024A;

c) Tipi i centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 93 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: n ë zonën kadastrale 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Shoqëria "*FAETHON*" sh.p.k. ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e përmendura në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, të lëshuara nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "*FAETHON*" sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "F*AETHON*" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

ANEKSI 1

KOORDINATAT E CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK
NË ZONËN KADASTRALE NR. 2444, BASHKIA LIBOHOVË, QARKU GJIROKASTËR
SHOQËRIA "*FAETHON*" SHPK

| **Pikat** | **Gauss Kryeger (E,N)** | | **Pikat** | **KRRGJSH (E,N)** | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **E** | **N** | **Nr.** | **E** | **N** |
| 1 | 4437694.153 | 4435724.251 | 1 | 522892.1908 | 4435372.105 |
| 2 | 4437969.681 | 4435565.608 | 2 | 523169.4699 | 4435216.574 |
| 3 | 4438080.089 | 4435353.294 | 3 | 523282.2498 | 4435005.524 |
| 4 | 4437975.025 | 4435185.869 | 4 | 523179.0778 | 4434836.938 |
| 5 | 4437848.823 | 4435172.205 | 5 | 523053.0439 | 4434821.858 |
| 6 | 4437638.417 | 4435194.728 | 6 | 522842.4088 | 4434842.015 |
| 7 | 4437378.848 | 4435208.005 | 7 | 522582.7191 | 4434852.376 |
| 8 | 4437209.651 | 4435142.933 | 8 | 522414.273 | 4434785.411 |
| 9 | 4436997.713 | 4435163.069 | 9 | 522202.1325 | 4434803.165 |
| 10 | 4436722.568 | 4435361.731 | 10 | 521924.7879 | 4434998.714 |
| 11 | 4436460.554 | 4435488.526 | 11 | 521661.3802 | 4435122.552 |
| 12 | 4436262.457 | 4435633.091 | 12 | 521461.6828 | 4435264.875 |
| 13 | 4436245.195 | 4435748.256 | 13 | 521443.1294 | 4435379.833 |
| 14 | 4436271.336 | 4436031.886 | 14 | 521466.0816 | 4435663.725 |
| 15 | 4436380.068 | 4436027.675 | 15 | 521574.8477 | 0555660.735 |
| 16 | 4436677.54 | 4436137.251 | 16 | 521871.0552 | 4435773.64 |
| 17 | 4437001.551 | 4436174.26 | 17 | 522194.6137 | 4435814.284 |
| 18 | 4437240.531 | 4436078.333 | 18 | 522434.6434 | 4435721.052 |
| 19 | 4437417.195 | 4436100.926 | 19 | 522611.0337 | 4435745.626 |

PLANI I VENDOSJES SE CENTRALIT FOTOVOLTAIK SH 1:6500




PLANI I VENDOSJES NE HARTE TOPOGRAFIKE SH 1:25,000



PLANI I VENDOSJES HARTE KADASTRALE SH 1:25,000



KOORDINATAT E KUFIJVE TE CENTRALIT

| PIKAT | Gauss Krveger (E, N) | | KRGSH (E,N) | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 4437694.153 | 4435724.251 | 522892.1908 | 4435372.105 |
| 2 | 4437969.681 | 4435565.608 | 523169.4699 | 4435216.574 |
| 3 | 4438080.089 | 4435353.294 | 523282.2498 | 4435005.524 |
| 4 | 4437975.025 | 4435185.869 | 523179.0778 | 4434836.938 |
| 5 | 4437648.823 | 4435172.205 | 523053.0439 | 4434821.858 |
| 6 | 4437638.417 | 4435194.728 | 522842.4088 | 4434842.015 |
| 7 | 4437378.848 | 4435208.005 | 522582.7191 | 4434852.376 |
| 8 | 4437209.651 | 4435142.933 | 522414.273 | 4434785.411 |
| 9 | 4436997.713 | 4435163.069 | 522202.1325 | 4434803.165 |
| 10 | 4436722.568 | 4435361.731 | 521924.7879 | 4434998.714 |
| 11 | 4436460.554 | 4435488.526 | 521661.3802 | 4435122.552 |
| 12 | 4436262.467 | 4435633.091 | 521461.6828 | 4435264.875 |
| 13 | 4436245.195 | 4435748.256 | 521443.1294 | 4435379.833 |
| 14 | 4436271.336 | 4436031.886 | 521466.0816 | 4435663.725 |
| 15 | 4436380.068 | 4436027.675 | 521574.8477 | 4435660.735 |
| 16 | 4436677.54 | 4436137.251 | 521871.0552 | 4435773.64 |
| 17 | 4437001.551 | 4436174.26 | 522194.6137 | 4435814.284 |
| 18 | 4437240.531 | 4436078.333 | 522434.6434 | 4435721.052 |
| 19 | 4437417.195 | 4436100.926 | 522611.0337 | 4435745.626 |

PLANI I VENDOSJES NE HARTE TOPOGRAFIKE SH 1:125,000




TREGUESIT E ZHVILLIMIT

NR KADASTRES: 2444
NR PARCELES: 4086